

## The philological conundrum of the engraving in Ardenica

**Abstract:** *The study focuses on two inscriptions, in Albanian and Aromanian, placed sideways on the so-called “Woodcut of Ardenica”, constituting the background to the icon of the Virgin and Holy Mother in the monastery in Ardenica, Fier (Albania). There is clear evidence that the author of both inscriptions – as well as of those in Greek and Latin located above and below the icon – must be the Orthodox monk Nektarios Terpos (: (A)rom. Nectarie Tärpu, Gr. Νεκτάριος Τέρπος, Alb. Nektar Tërpo), as not incidentally, part of it bears his signature (: <ὁ ἱερονόμαχος Νεκτάριος>) along with the year 1731 (: <αψλα>) which in fact coincides with his lifetime.*

*After describing the paratextual framework, the essay focuses on the philological analysis of the two inscriptions, which in turn enables a comparison of the graphic systems used in the tradition of written Albanian and Aromanian, within the cultural Orthodox area in this compact Albanian-speaking region. The essay explores and discusses as well some deviations in the common graphic code based on the Greek alphabet. It also examines the origin of the graphemes which are inconsistent with this alphabet. It can be asserted that these are loans, either borrowed from the Latin alphabet or from a graphic code with an authentic alphabet which, most probably and not incidentally, served as a common pillar to the cultures of both written languages.*

**Keywords:** *Monastery in Ardenica, Albanian, Greek, Aromanian alphabet, Engraving from Ardenica, Nectarie Tärpu, Νεκτάριος Τέρπος.*

### 1 Fjalë hyrëse

Në këtë punim jemi fokusuar në dy mbishkrime shqip dhe arumanisht që feksin në spaciot anësore të së ashtuquajturës “Gravurë e Ardenicës”, e cila përcjell në sfond ikonën e Virgjëreshës dhe Perëndilemes (: [Hyjlindëses] së Manastirit) të Ardenicës (rrethi i Fierit/Shqipëri). Të dyja këto mbishkrime sikurse edhe ato greqisht dhe latinisht të pozicionuara në spaciot lart dhe poshtë saj mendohet, pas gjase jo pa të drejtë, të kenë për autor murgun ortodoks (shq.) Nektar Tërpo (: (a)rom. Nectarie Tärpu, gr. Νεκτάριος

Τέρπος), meqë pjesë e tyre janë jo rastësisht edhe firma (: <ὁ ἱερονόμαχος Νεκτάριος>) dhe datimi i saj në gjallje të tij, shi në vitin 1731 (: <αψλα>).

Asgjëmangut u desh të kalonin më se dy shekuj, kur kjo gravurë, përkatësisht mbishkrimet e saj, të bëheshin pronë e diskursit shkencor-intelektual në albanologji dhe rumunistikë, bash në vitin 1952, kur Shuteriqi (1952 14v.) kumtoi i pari praninë e saj si përmendore e hershme në kulturën e shkrimit shqip, ndërkohë që vetë gravura paskësh hyrë si e tillë dy vite më parë (1950) në fondet e arkivit të Institutit të atëhershëm të Shkencave (Tiranë). Ky kumt i Shuteriqit përthithi menjëherë vëmendjen e rretheve shkencore-intelektuale të kohës, sidomos ato në fushën e filologjisë (a)rumune, meqë mbishkrimi arumanisht gëzon sot e gjithë ditën statusin e dëshmisë së parë të njohur në kulturën e shkrimit arumanisht. Andaj nuk kemi përse bëjmë aspak çudi që ai vijon të jetë objekt diskursi kulturor-historik e filologjik në ato rrethe (Drimba 1955 341vv., Caragiu Marioçeanu 1962 112v, 1968 6v., Tıpau 2010 239vv., Nevaci 2014 297vv.). Interesim të veçantë përjeton ndërkohë vetë gravura bashkë me autorin e saj qoftë si dëshmi e atij peizazhi kulturor më shumë se një etnik, ashtu edhe, madje sidomos, si sinor orientues në hulumtimin e historisë së Kishës Ortodokse në trevat e Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut përgjatë shek. XVIII. (Giacunis 2017 209vv.). Përndryshe, disi më rrallë ngjerojmë momente debati në diskursin shkencor-albanologjik, të cilat edhe kur na shfaqen, përcjellin kryesisht në mënyrë të përsëritur përshkrime të natyrës njohëse-enciklopedike. (Shuteriqi 1976 107, Popa 1998 94v. etj.) Përjashtim bëjnë në këtë rast do ndërhyrje të cema të Hetzer-it (1982 140v.), i cili nuk ngurron aspak të shtojë radhën dhe numrin e pikëpyetjeve e të pikëçuditëseve, sa i përket interpretimit filologjik në mjedisin kulturor-fetar të kohës, sikurse historisë së vetë gravurës, që vjen me thënë të rrethanave të përfuturit të saj.

Një frymë të re në debatin shkencor me orientim ndërdisiplinor e përjetojmë së fundi në monografinë “Rreth alfabetit të shqipes” (Shkup – Prishtinë – Tiranë 2008) me autor studiuesin dhe filologun e njohur të shkrimeve shqip me alfabet grek, Xhevat Lloshin, i cili i kushton një krye të veçantë rolit të autorëve me prejardhje arumune në kulturën e shkrimit shqip, përkatësisht ndikimit të tyre të ndërsjellë në lëvrimin e shqipes dhe të arumanishtes, bash në ato treva me bashkësi multietnike të besimit ortodoks, ku greqishtja (kishtare-bizantine) gjëllinte atëbotë si gjuhë liturgjike duke gëzuar si e tillë – së bashku me greqishten e vjetër – edhe statusin e gjuhës së prestigjit kulturor, sikurse edhe me greqishten e re në rolin e ndërmjetësit komunikativ në formimin intelektual-fetar të kohës. Sipas Lloshit (f. 294vv.), Nektar Tërpo u paraprin gjithë autorëve të tjerë arumunë që nuk kanë munguar të lëvrojnë e për rrjedhojë edhe të pasurojnë kulturën e shkrimit shqip me alfabet grek, si p.sh. Anastas Kavalioti (= gr. Θεοδώρος Αναστασιός Καβαλλιώτης, (a)rum. Theodore

Kavalliotis), Kostë Xhehani, Daniel Voskopojar ( = gr. Δανιήλ Μοσχοπολίτης, arum. Daniel Moscopolis), Evstrat Vithkuqari, Kostandin Cepi (Vithkuqari) etj. Gjithsesi, më fort se sa të rreket me zhbirilime pa vlerë ndaj përkatësisë gjuhësore-etnike të njërit apo tjetrit shqipshkrues – çka është vërtet vetëm për t'u lëvduar (!!!) –, Lloshi synon t'i përcjellë lexuesit fakte dhe argumente pozitive në përsiatjet e veta, të shndërruara ndërkohë në bindje, që autorët arumunë të këtyre trevave kanë ndërmjetësuar në shkrimin shqip përpos sistemeve alfabetike për arumanishten edhe modele strukturash të gatshme, të fiksuara në ndërgjegjen e vet gjuhësore si folës nativë të saj, duke ndikuar kështu dukshëm në hartimin e teksteve dhe glossarëve, ku pranëvihen shqipja me arumanishten.

Janë pikërisht këto rrethana të përmbledhura thukët në këto fjalë hyrëse që nxitën shkruetin e këtyre radhëve, t'i rikthehet atij qerthulli problemor që parakupton interpretimi filologjik i mbishkrimeve arumanisht dhe shqip në gravurën në fjalë, të para këto në ndërlidhni me njëri-tjetrin, sikurse edhe në kontekstin paratekstual përkatës.

Le të ndalemi së pari shkurt në kornizën paratekstuale të tekstit dygjuhësh, duke u përqëndruar kryesisht në emrin e autorit, jetën dhe trashëgiminë e tij letrare si edhe në rrethanat historike të përfutimit të gravurës, ku gjëlljnë mbishkrimet në fjalë.

## **2 Korniza paratekstuale**

### **2.1. Nektar Tërpo dhe vepra e tij**

Tërpo lindi pas gjase në gjysmën e dytë të shek. XVII në Voskopoje (sot rrethi i Korçës/Shqipëri) në një familje të njohur dhe të kamur të bashkësisë anase arumune në atë qytet. Në Akademinë e mirënjohur të Voskopojes mori edhe formimin e plotë intelektual-fetar, bash ashtu siç na përshfaqet në veprën e tij, ku dëshmon të jetë familiarizuar qysh në të ri me autorët antikë, tekstet biblike, historitë e apostujve dhe të Eterve të Kishës etj. Pas përfundimit të studimeve Tërpo iu dha jetës monastike duke ndërmarrë së pari një udhëtim pelegrinazhi në Malin Atos. Aty jetoj do kohë në ngulimin monastik (*Skete*) të Shën Anës, derisa u shugurua murg. Më pas u transferua si murg i thjeshtë në Manastirin e Shën Naumit në Liqenin e Ohrit e që këtej si abat në Manastirin e Virgjëreshës dhe Perëndilemes të Ardenicës. Gjatë kohës së qëndrimit në këtë manastir duhet të jetë angazhuar intensivisht me rinovime të ndryshme në ambientet e tij të brendshme. Mësojmë gjithashtu që këtë kohë të jenë rekrutuar shumë murgj të rinj duke e shndërruar kështu manastirin në një vatrë edukimi intelektual-fetar për bashkësinë ortodokse të gjithë zonës përreth.

Angazhimi i tij i vazhdueshëm për ruajtjen dhe mbarështimin e besimit dhe të normave zakonore në jetën ortodokse (sidomos duke iu kundërvënë hapur dukurisë së laramanisë) shkaktoi me sa duket konflikt me organet e

pushtetit vendor, çka e detyroi të mërgonte në perëndim. Mendohet të jetë ndarë nga jeta në mërgim aty nga fundi i vitit 1740 ose fillimi i vitit 1741 në Venedik, pra pasi kishte përjetuar dhe gëzuar së paku botimin dhe jehonën fatlume të veprës dhe emrit të tij në botën ortodokse. Si dëshmi e kësaj jehone mund të sillen ndonjë e dhënë dokumentare mbi portretin e tij në Kishën e Shën Apostujve në Voskopojë, së cilës ndërkohë i ka humbur nami e nishani edhe si ndërtesë (Giacumis 2017 209v).

Siç përmendëm shkurt më lart, Tërpo u përkujdes në Venedik edhe për botimin e veprës së tij të parë e të fundit, e cila u bë atëbotë menjëherë *bestseller*, duke i dhënë famë e zulumë autorit qysh në gjallje të vet: „ΒΙΒΛΑΠΙΟΝ ΚΑΛΟΥΜΕΝΟΝ ΠΙΣΤΙΣ [...] ΝΕΑΠΟΙΟΥ ΤΕΡΠΙΟΥ [...]” (ΕΝΕΤΙΗ,ΣΙ, 1732. Παρά Νικολάω τως Σάρω, αψιβ’ [1732] Con Licenza de’ Superiori e Privilegio.) Ribotimet e vazhdueshme të saj – deri një duzinë sosh me gjithë-gjithë 10.000 ekzemplarë – dëshmojnë më së miri receptionin e saj ndër besimtarët fatlumë, të cilët mësonin aty pjesë të Biblës, jetën e Etërve të Kishës si edhe copëza leximi prej autorëve të ndryshëm të antikitetit. Siç mësojmë edhe prej Tjipau-t (2010 239vv.), sukcesi i ribotimeve të radhës u kushtëzua sigurisht me destinacionin e veprës e në bashkëlidhje me të edhe me stilin, përkatësisht mënyrën e dhënies së kumtit prej autorit. Prashtu autori synoi më fort të arrijë me këtë vepër masën e gjerë e kryesisht analfabete të besimtarëve ortodoksë, andaj edhe hartimi i tekstit ishte konceptuar prej tij më fort si lexim me zë para një auditori të thjeshtë. Është pikërisht ky synim dhe kjo mënyrë hartimi e tekstit që na lejon të përsiasim një radius shumëfish më të madh të receptionit të kësaj vepre në kohë e hapësirë. Me këtë rast nuk mund të kalojmë aspak në heshtje as mëtimin, që gjithçka që përmbante kjo vepër nuk binte assesi në kundërshti me parimet dhe normat e Kishës Katolike-Romake, bash ashtu siç theksohet edhe në lejën e botimit si i vetmi peritekst i rrjedhshëm në gjithë veprën që e lexojmë edhe në italisht, si vijon:

<Noi Reformatori / dello Studio di Padova // AVendo veduto per la Fede di Revisione, ed Approbatione del P. F. Tomaso Maria Gennari Inquisitore nel libro intitolato: *Credenza di quelle cose, che confessiamo*, non v’esser cos’ alcuna contro la Santa Fede Cattolica, e parimente per Attestato del Segretario Nostro, niente contro Principi, e buoni costumi, concediamo Licenza ad Antonio Bartoli Stampatore, che possi esser stampato, osservando gl’ordini in materia di Stampe, e presentando le solite copie alle Pubbliche Librerie di Venezia, e di Padova.

Dat. li 13. Novembre 1731. / Carlo Ruzini Kav. Prec. Ref. / Z. Pietro Pasqualigo Ref. / Agostino Galdini Segretario> (fol. 9r)<sup>1</sup>

1 Këtu feksin përpos emrave të censorëve edhe leja e shtypit në shtypshkronjën e

Këtij periteksti të dubluar greqisht-italisht<sup>2</sup> i prijnë mbishkrimet në katër gjuhë në të ashtuquajturën “Gravurë e Ardenicës”, historinë e së cilës e kemi bërë objekt diskutimi në vijim:

## 2.2 Gravura e Ardenicës

### 2.2.1 Historiku i gravurës – një *puzzle* i pazgjidhur deri sot

Kur shfletojmë veprën, gravurën në fjalë e pikasim dhe e ngjerojmë të vendosur menjëherë pas fjalëve hyrëse në një folje më vete e të panumëruar (fol. 5r). E në këtë pozicion ajo shoqëron në vazhdimësi e pa ndonjë ndryshim të dukshëm – d.m.th duke pasqyruar të njëjtat mbishkrime shqip, arumanisht, greqisht dhe latinisht – disa ribotime të radhës që përjetoi kjo vepër, së paku sosh deri në fund të shek. XVIII.<sup>3</sup> E theksojmë që në fillim këtë rrethanë, meqë si historikun e përfuturit dhe të studimit të kësaj gravure, përkatësisht atë të mbishkrimeve në të e shoqëron sot e gjithë ditën një enigmë, më saktë një pseudoenigmë që nxiti dikur zbulimi i saj zyrtar në diskursin shkencor të kohës.

Prashtu Shuteriqi (1952 15) kumton fillimisht si të mirëqenë e më pas në mënyrë të përsëritur (1976 108) mungesën e këtyre mbishkrimeve në Gravurën e Ardenicës që paska botuar Tërpo në librin e vet, meqë në referencat bibliografike të Legrand-it (1918 237v.) kjo gravurë në fakt përmendet, por pa u cituar mbishkrimi shqip në të. Këtij deduksioni, që sot nuk e kemi aspak të vështirë me e klasifikuar si të pagjetur, i shtohet edhe paqartësia në përshkrimin e gravurës që kishte shfrytëzuar Shuteriqi në kumtin e tij informativ. Bëhet fjalë aty për një gravurë që paskësh hyrë dikur në fondet e Arkivit të Institutit të Shkencave e që ndërkohë rezulton të jetë bjerrë një herë e përgjithmonë. Çfarë paska qenë kjo gravurë konkretisht? Një klishe në dru (: angl. *Woodcut*, gjerm. *Holzchnitt*) e ikonës së Virgjëreshës dhe Perëndilemes së Ardenicës, që shërbente dikur si stampë për ta shumëfishuar e shpërndarë në letër ndër besimtarë? Në rast se po, vërtet në dru paska shkruar a gdhendur Tërpo ndër të tjera edhe emrin e tij me datën përkatëse? Apo mos është ulur e ka mbushur e firmosur fletë-gravura të tëra për besimtarët ortodoksë shqiptarë e arumunë? Apo

---

Antonio Bartoliti, emri i të cilit del në frontespice në pesë ribotimet e radhës së këtij libri (Tjipau 2010 242), ndërsa në botimin e parë lexojmë në frontespice <Παρά Νικολάου τῶς Σάρου> [prej Nikolla Saros].

2 Në frontespice lexojmë edhe formulën e zakonshme për botimet e kohës në latinisht: <Con Licenza de’ Superiori, e Privilegio>.

3 Studiuues të ndryshëm citojnë rreth 12 botime të kësaj vepre: 1732, 1733, 1734, 1750, 1755, 1756, 1779, 1785, 1813, 1818 etj. Hollësisht për këtë Tjipau (2010 242v), i cili shton se pas botimit të dytë gravurës së librit i shtohet edhe bula e Papa Leonit X. E paqartë mbetet në botimin e parë shtypshkronja, meqë për shtypin e librit ishte autorizuar në lejën e caktuar Antonio Bartoli, ndërsa në frontespice shfaqet emri i Nikolla Saros (shën. 1).

ky material arkivor s'ka qenë gjë tjetër veçse një fotografi që i kish bërë dikush dikur asaj gravure të botuar në librin e Tërpos duke ia “shitur” si origjinale arkivit të Institutit të Shkencave? Pyetje mbi pyetje këto që as Hetzer-i (1982 141v.) me idealizmin e tij të mirënjohur prej bibliografi dhe filologu në zâ nuk u dha dot dum e, duke mos pasur në dispozicion as ndonjë ekzemplar original të botimit të parë të veprës së Tërpos, përfundon me dilemën se mos ndoshta atëbotë paska pasur dy klishe në dru të asaj ikone: njëra me dhe tjetra pa mbishkrimet në fjalë.

Asgjëmangut, prania e mbishkrimeve në gravurën që përcjell vepra qysh në botimin e saj të parë ndihmon së paku të rrudhim variantet potenciale të klisheve të saj në dru a tjetër material që përdorëshin atëbotë për shumëfishim. Është pikërisht kjo rrethanë, përkatësisht mungesa deri sot e çdo lloj dëshmie materiale dhe dokumentimi tjetër historik, që na nxit të pjesëmarrim që në fillim në debatin shkencor duke përsiatuar si të mirëqenë një zgjidhje alternative, sipas së cilës autori ase autorizuesi i këtyre mbishkrimeve, Nektar Tërpo, duhet ta ketë vënë në dispozicion, në mos ta ketë konceptuar dhe realizuar këtë gravurë shi në bashkëlidhje me botimin e veprës së vet, çka vjen me thënë jo për ta shpërndarë a tregtuar më vete, ashtu të shtypur e shumëfishuar ndër besimtarët që vizitonin atëbotë manastirin.



Gravura e Ardenicës  
(Burimi: Τέρπος, Νεκτάριος,  
Βιβλιάριον καλούμενον πίστις,  
Παρά Νικολάω Σάρω, Ενετίησι  
1732, f. 11)

### 2.2.2 Ikona në qendër të gravurës

Siç mësojmë edhe nga një vështrim sado i përciptë i gravurës, ajo i përkushtohet Virgjëreshës dhe Perëndilemes së Ardenicës (shih § 3) duke evokuar kështu manastirin, ku Tërpo kishte qenë aktiv deri atë kohë. Këtë rrethanë përcjell vetë ikona, që zë vendin qendror në gravurë e në të cilën qëmtojmë do monograme, të cilat i ndeshim zakonisht në çdo ikonë të Perëndilemes në Kishën Ortodokse: <MP | ΘV> (= Μητέρα Θεού [nënë e zotit]); <IC | XC> (= Ἰεσοῦς Χριστός); (rreth nimbit të Birit) <O | ω | N> (= [έγώ είμι] ὁ ὢν [[unë jam] ai që jam]): Exodus 3 14)<sup>4</sup>

Sa i përket ekzistencës së (dikurshme të) kësaj ikone në Manastirin e Ardenicës, lejohemi të kumtojmë thukët jo thjesht dhe vetëm mungesën e saj në ambientet e sotme të manastirit, por edhe atë të çdo lloj dokumentacioni historik lidhur me praninë e saj dikur në ato ambiente. Kështu sipas Popës (1998 95) “Ikona në gravurë nuk dihet se ku gjendet; fotografia e gravurës ka të ngjarë të jetë marrë nga libri Pistis (*Besim*) i Nektar Tërpos”. Asgjëmangut, janë pikërisht këto rrethana së bashku me informacionin jo të parëndësishëm të Popës se vetë gravura që paskësh hyrë dikur në arkivin e Institutit të Shkencave, kishte qenë thjesht një fotografi e jo një klishe shumëfishimi në dru, çka na lejon tash të tumirim pa hezituar aspak dyshimin e tij se mos vetë kjo dëshmi të ketë qenë thjesht kopje (fotografi) e asaj gravure që ndeshim në librin e Tërpos (fol. 5r). Duke ecur në këtë hulli, d.m.th. duke e marrë këtë dyshim si të mirëqenë, nuk do të ishim larg së vërtetës, po të përsiasnim, që e gjithë gravura në tërësinë e saj (sikurse shumë syresh në vepër) të jetë ideuar dhe realizuar si e tillë prej vetë Tërpos e me synimin e thjeshtë për të plotësuar veprën me peritextet përkatëse.

Përçark ikonës vërejmë gjithashtu, përpos zburimeve të zakonshme të artit bizantin me drurë të shenjtë (: selvi etj.) edhe mbishkrimet në katër gjuhë, të cilat i kemi bërë objekt diskutimi në rubrikën që vijon, duke i dhënë kështu formë dhe kuptim edhe studimit tonë të natyrës historike-kulturore dhe gjuhësore-filologjike:

### 2.2.3 Mbishkrimet përçark ikonës

Gravura e Perëndilemes së Ardenicës është e vetmja gravurë në gjithë veprën e Tërpos ku lexojmë mbishkrime në më shumë se një gjuhë: ndër to, përpos greqishtes që mbizotëron gjithkund në vepër, edhe syresh arumanisht, shqip dhe latinisht. Le të përcjellim fillimisht këto mbishkrime, si: a) riprodhime diplomatike dhe b) riprodhime të normalizuara me c) përkthimet interlineare përkatëse.

4 Në cepin sipër majtas ikonës dallojmë ende monograme në tri radhë; tepër të vështira për t'u lexuar prej nesh, përpos radhës së tretë: <M[ητέ]ρ>. Për shpjegime të rastit në këtë ikonë, shkruesi i këtyre radhëve i detyrohet me mirënjohje të thellë Fra Serafini (Austri).

Lart:

- (a) <Η ΠΑΡΘΕΝΟΣ, Κ[ΑΙ] ΘΕÓ | ΤΟΚΟΣ ΑΡΔΕΥΟΥΣΑ>  
(b) /Η Παρθένος και Θεότοκος Άρδέουσα/  
(c) “Virgjëresha dhe Perëndilema e Ardevusa-s”<sup>5</sup>

Poshtë: greqisht (2, 4, 5) dhe latinisht (3)

- (a) <ΑΝΑΣΣΑ ΜΗΤΡΟ ΠΑΡΘΕΝΕ | ΒΟΗΘΗΣΟΝ ΤΩΙΣ ΔΟΥΛΟΙΣΣΟΝ>  
(b) /“Ανασσα μητροπάρθενε βοήθησον τοις δούλοις σου/  
(c) “Sundimtare, mëmë-virgjëreshë ndihmo shërbëtorët e tu”
- (a) <Regina Mater | et Virgo auxilia: | re servis tuis>  
(b) /Regina mater et virgo auxiliare servis tuis/  
(c) “Mbretëreshë, mëmë dhe virgjëreshë ndihmo shërbëtorët e tu”
- (a) <αψλα>  
(c) “[viti] 1731”
- (a) <ὁ ἱερομόναχος Νεκτάριος>  
(c) “murgu Nektar”

Majtas: arumanisht

- (a) <Βήργιρι Μγμιάλ | τγμνε λι ὦρε | τρένοϊ πεκι| τόη λου:>  
(b) /Βήργιρι Μούμι άλ τουμνελι ὦρε τρέ νοϊ πεκιτόηλοι/  
(c) “Virgjinë, Mëmë e Zotit lutu për ne mëkatarët”

Djathtas: shqip

- (a) <Βήργκην e | Μάμε έπερεν: | τίς γρώ πρέ | νέε φαϊ τόρε του:>  
(b) /Βήργκηνε Μάμε έπερεντίς ούρώ πρέ νέε φαϊτόρετοι/  
(c) “Virgjinë, Mëmë e Perëndisë \*uro për ne fajtorët”

### **Vëzhgime paraprake**

Ndër mbishkrimet e paraqitura më lart janë ato në greqisht dhe latinisht (nr. 1-5), të cilat nuk përcjellin vështirësi interpretimi të natyrës tekstuale-historike:


- Prashtu në mbishkrimin lart (nr. 1) kemi emërtimin e vetë ikonës që i kushtohet Virgjëreshës dhe Perëndilemes së Ardevusa-s (= shq. *Ardenicës*).

---

5 Në toponiminë zyrtare, sikurse edhe në kujtesën popullore të mbarë zonës emri i vendndodhjes së manastirit quhet *Ardenica*, e cila i ka dhënë emrin sot: *Manastiri i Ardenicës*. Shkruesi i këtyre radhëve e ka të vështirë të vendosë një lidhje historike-gjuhësore të natyrshme të *Ardenica*-s me emrin ase emërtimin burimor të manastirit: gr. Άρδέουσα.



- Në spacion e poshtme të gravurës lexojmë ndër të tjera në greqisht, përpos emrit të murgut Tërpo (nr. 5) dhe informacionit të vitit të nënshkrimit (nr. 4 – me numrat që përfaqësojnë shkronjat e alfabetit grek) edhe
- lutjen që i drejtohet Mëmë-Virgjëreshës si sundimtare (: "Ανασσα gr. vj. "Zonjë sunduese, sundimtare") me iu gjendur pranë e me iu ndihmuar skllëvërve të saj, një përdorim ky i kahershëm metaforik për besimtarët ortodoksë si shërbëtorë të bindur që i nënshtrohen symbyllas hirit të saj. (nr. 2)
- Të njëjtën lutje ngjërojmë edhe në variantin latinisht (nr. 3) të vendosur poshtë-majtas simotrës greqisht. Shmangiet në këtë rast janë të natyrës semantike-sinonimike, khs.: gr. ἄνασσα ~ lat. *regina*; ose gramatikore-fjalëformuese, khs.: gr. μητροπάρενε (kompozitë) ~ lat. *mater et virgo*.
- Tekstet arumanisht (nr. 6) dhe shqip (nr. 7) përcjellin po ashtu një lutje që është sa e përbashkët në përmbajtje dhe formë mes syresh, aq edhe e ndryshme prej gjegjëseve greqisht dhe latinisht, meqë besimtari i bindur dhe i nënshtroar si mëkatar i përjetshëm i falet Perëndilemes së virgjër që të lutet për të. I një natyre tjetër është edhe qerthulli problemor filologjik dhe ai paratekstual (kulturor-historik) që rrokin së bashku këto dy lutje, andaj jemi ka ndalemi hollësisht në vijim, në një rubrikë të veçantë.
- Së fundi duhet të vëmë në dukje – për mungesë fontesh grafike – edhe vështirësitë që kemi në këtë studim lidhur me pasqyrimin me besnikëri të disa shkronjave të veçanta që ndeshim në mbishkrimet arumanisht dhe shqip e që janë pas gjase të huaja në alfabetin e greqishtes, khs. arum. <τγμνε[Λ]i> dhe <πεκικτό[Η]λοι>, sikurse inicialen e grafisë shq. <[B]ήργκηνε>, të cilën do ta njohim paraprakisht *ad hoc* si grafemë të stilizuar të *beta-s* (= *vita-s*) së alfabetit të greqishtes.<sup>6</sup> Këto zgjidhje të përkohshme po i pasqyrojmë si vijon:

<Λ lh B> = 

### 3 Tentativë për një autopsy të mbishkrimeve arumanisht dhe shqip

Siç cekëm më lart, mbishkrimet arumanisht (nr. 6) dhe shqip (nr. 7) përcjellin shumë ngjashmëri me njëri-tjetrin, çka ia vlen vërtet të ndjekim po atë hulli që përshkoi i pari Lloshi (2008 294vv.), kur i këqyri së bashku me lupën e filologut. Ndër përbashkësitë që i afrojnë më së shumti, përmendim ndër të tjera:

- 1) Vendi i tyre i parë në kulturën (ortodokse) të shkrimit arumun, përkatësisht në kulturën e shkrimit shqip në Arealin Kulturor Ortodoks në jug të hapësirës kompakte shqipfolëse, bash ashtu siç

6 Burimi i këtyre grafemave do të trajtohet hollësisht më poshtë në § 4.2.2.

dëshmojnë burimet shkrimore që njohim deri sot.<sup>7</sup>

- 2) Shmangiet e përbashkëta të natyrës kuptimore-semantike dhe sintaksore në të dyja tekstet njëfjali (nr. 6, 7) kundrejt lutjeve greqisht dhe latinisht (nr. 2, 3), çka na lejon të mëtojmë si të mirëqenë mëdyshjen e cituar më sipër se kemi të bëjmë me një lutje që sa i afron këto dy mbishkrime me njëri-tjetrin, aq edhe i largon ato prej gjegjëseve greqisht (nr. 2) dhe latinisht (nr. 3) në gravurë, khs.: a) (predikat) arum./shq. *oră/uro* “lutu” ~ gr./lat. βοήθησον/*auxilare* “ndihmo” dhe b) (plotës/frazë parafjalore) arum. *tre noi pecătoșli* = shq. *për në fajtorëtë* ~ (kundrinë pa parafjalë/frazë emërore) gr. τοις δούλοις σου = lat. *servis tuis*.
- 3) Përdorimi në shkrimet përkatëse i një kodi të ngjashëm alfabetik me bazë alfabetin e greqishtes, duke e plotësuar atë me kombinime shkronjash dhe mjetesh grafike greqisht, përkatësisht grafema të huaja ase për të pasqyruar në shkrim tinguj me vlerë funksionale (= fonema) që mungojnë në inventarin e sistemit fonetik/grafik të greqishtes, khs.: (arum./shq.) <e> = IPA [ə] (: arum. *ă* = shq. *ë*); arum. <lh> = IPA [ʃ] (: arum. *ș*) dhe <Λ> = IPA [dz] (: arum. *đ*).

Janë të paktën këto tri tipare të përbashkëta, të renditura më lart – ndër to sidomos vendi i tyre i parë në secilën kulturë anase – që sendërtojnë një qerthull problemor të ngjashëm, sa i përket edhe rindërtimit tentativ të fazave të mëhershme në secilën traditë shkrimi. Në këtë rast ndihmon sigurisht analiza filologjike e teksteve në veçanti, siç u jemi përkushtuar në dy nënrubrikat e mëposhtme:

### 3.1 Analizë filologjike e tekstit shqip

Marrëdhëniet *grafi – fon – fonemë* përcjellin tek-tuk ndonjë vështirësi interpretimi në (a) tekstin shqip (të normalizuar) me alfabet grek, sa i përket tejkshkrimit (b) me kodin e sotëm alfabetik të shqipes standarde, përkatësisht (c) me atë të fondit fonetik ndërkombëtar (IPA); sikurse (d) glosimit të tij. Këto katër operacione po i paraqesim të sistematizura më poshtë:

(a) <Βήργκινε Μάμε	έ	περεντίσ	ούρώ	πρè	νèε	φαϊτόρετοι>	
(b) /Virjinë	Mame	e	Perëndis	uro	prè	nè	fajtorëtë/
(c) [vir'jinə	ma'me	e	perën'dis'	uró	prə	ne:	faj'torətə]
(d) NOM-SG	NOM-SG ART	GEN-SG-DEF	2SG-IMP	PREP	1PL-ACC	ACC-PL-DEF	
Virgin	mother	of	God	pray	for	us	culprits

7 Kemi lënë këtu jashtë vështrimit tekstin e hershëm shqip (toskërisht), të njohur si “Pericope evangelica” e Shën Matheut (shek. 14 ?), meqë nuk kemi asnjë të dhënë lidhur me autorin dhe vendin ku është përfutur. Hollësisht së fundi Belluscio 2012 49vv.

### **Vëzhgime paraprake:**

Siç mund të këqyrim tekstin njëfjali prej secilës perspektivë studimi, mund të përmbledhim shkurt do vëzhgime paraprake, si vijon:

- Teksti shqip – siç është vënë në dukje deri sot (Shuteriqi 1952 14v.) – përcjell tipare dialektore të gegnishtes, më saktë (të shqipës së shkruar atëbotë: Lloshi 2008 297) në nëndialektin gegë të Shqipërisë së Mesme, me qendër kryesore urbane Elbasanin, që vjen me thënë duke iu shmangur në hapësirë asaj zone dialektore toske-veriore, ku gjellinte dikur sikurse sot e gjithë ditën Manastiri i Ardenicës. Le të sjellim këtu për krahasim, ndër të tjera, fjalëformën *virgjinë* (pa rotacizim të *-n-së* ndërzanore); apo atë të përemrit dëftor <nee> (= *nē* = [ne:]) me dyfishim të zanores si konvencion i hershëm grafik për pasqyrimin e gjatësisë së saj. Më pak domethënës është timbri i zanores së theksuar te (Elb.) *mame* (para një bashkëtingëlloreje hundore, kundrejt tosk. dial. *mëme!*<sup>8</sup>), meqë në trevat e toskërishtes veriore nuk është e rrallë kjo fjalëformë, khs. (Berat) *mamë*.
- Asgjëmangut, marrëdhëniet *grafi – fon – fonemë* përcjellin zgjidhje thujtë optimale prej autorit ase kopjuesit të këtij teksti njëfjali, ku grafemave njëshkronjëshe apo të kombinuara dysh u përgjigjet në shqipe zakonisht vetëm një vlerë funksionale, khs.: <B> = v, <ρ> = r, <ν> = n, <Μ μ> = m, <π> = p, <ε> = e, <σ> = s, <φ> = f, <τ> = t, <ντ> = nd, (lat.) <e> = ě, po ashtu edhe <γκ> = gj, <ϊ> (~ <ς><sup>9</sup>) = j, sikurse ligatura (gr. <ϣ> :) <ου> = u etj. Të njëjtën vlerë funksionale dëshmojnë edhe variantet letrare dhe dorëshkrimore (por pa shpërndarje alografike) të shkronjave <ή, η, ί> = i dhe <ὠ, ὀ> = o që shfaqen si të tilla gjithkund e me të njëjtën vlerë njëfunksionale edhe në kulturën e shkrimit grek të kohës.

Krahas këtyre vëzhgimeve të natyrës grafike-funksionale lejohemi të shtojmë rishtas që shkronjën inciale të fjalisë shqip e njohim paraprakisht *ad hoc* si grafemë të stilizuar të *beta-s* (= *vita-s*) së alfabetit të greqishtes: <B> = v = [v]. (shih §§ 2.2.3; 4.2.2)

- Shpjegim kërkon gjithsesi digrami <-οι> si fundore e grafisë <φαιτόρετ-οι>, të cilën e kemi tejshkruar përkohësisht në kursiv me *-ë* për ta rimarrë rishtas në shqyrtim bashkëvajtje me gjegjësën e vet në tekstin arumanisht, ku shfaqet i njëjti problem gjuhësor-grafik (sh. § 3.2)
- Sa i përket analizës semantike-sintaksore të këtij teksti njëfjali, kemi të bëjmë edhe këtu me një fjali të thjeshtë urdhërore-nxitëse, ku subjekti shoqërohet me një ndajshtim si frazë emërore: /virgjinë/ ← /mame (e

8 Kuntim me gojë prej informantëve të ndryshëm të kësaj zone.

9 Mbishkrimi shqip lejon edhe një lexim me (lat.-it.) <j> (sh. Lloshi 2008 299), së cilës i është mbivendosur trema (dy pikat sipër).

Perëndis)/, ndërsa predikati: /uro/ ndiqet nga një plotësi i shoqëruar gjithashtu me ndajstimin përkatës: /(për) në/ ← /fajtorëtë/.

Një shpjegim të natyrës semantike dhe historike-kulturore kërkon pa dyshim konstatimi i Lloshit, kur interpreton fjalëformën foljore shq. *uro(!)* me kuptimin sipas tij të pazakonshëm <sup>2</sup>“lutu(!)”, për të cilin do të ndalemi gjithashtu më poshtë. (§ 3.2)

### 3.2 Analizë filologjike e tekstit arumanisht

Le të kalojmë tash në analizën filologjike të tekstit arumanisht, anipse deri sot nuk kanë munguar assesitë autopsitë e tij në rumunistikë (Drimba 1955 341vv.; Caragiu Marioțeanu 1962 112v., 1968 7; Nevaci 2014 297vv. etj.). Analiza e bërë nga të tria këndvështrimet e fiksuara më lart, përcjell natyrshëm rezultatet e mëposhtme:

- |     |  |                                       |
|-----|--|---------------------------------------|
| (a) | /Βήρυρι Μούμι άλ τουμνελι              | ώρε τρε νόϊ πεκιτόθλοϊ/ <sup>10</sup> |
| (b) | /Viryiră <sup>11</sup> Mumă al Dumneđă | oră tre noi pecătoșli/                |
| (c) | [,virjirə ,mumə al dumne'dză           | ,orə tre ,noi pekə'toʃli]             |
| (d) | NOM-SG NOM-SG ART GEN-SG-DEF           | 2SG-IMP PREP 1PL ACC-PL-DEF           |
|     | Virgin mother of God                   | pray for us sinners                   |

#### Vëzhgime paraprake

Duke ndjekur të njëjtën metodikë studimi sikurse për tekstin shqip (§ 3.1) le të mjaftohemi fillimisht me do vërejtje paraprake, si vijon:

- Teksti arumanisht përcjell tipare të të folmeve arumune, siç i ndeshim pas gjase sot e gjithë ditën<sup>12</sup> në Shqipëri në jug të lumit Shkumbin e që dëshmojnë bindshëm një bashkëjetesë të hershme me shqipfolës nativë toskë. Le të krahasojmë për këtë, fjalën e parë: arum. *viryiră*,

10 Riprodhimi dhe tejskrimi ynë u shmanget në ndonjë rast tentativave të derisotme në rumunistikë, khs. <Βήρυριε Μυμά-λ τυμνεζι ώρε τρε νόϊ πεκι[ε]τό...λοϊ> (Drimba 1955 344); /Viryiră muma-l dumneđă oră tre noi pecătoșli/ (Caragiu Marioțeanu 1968 7); përshtatur në kodin e sotëm alfabetik: /Viryiră muma-al Dumneđă, oră tre noi pecătoșli/ (Kahl 2006 247v.) Korrekturë leximi edhe te Nevaci (2014 297v.). Sh. edhe Atanasov 2002 78.

11 Sa i përket tejskrimit të kësaj fjale me grafemën <y> (= <y> – Kahl 2006 247v) u jemi përmbajtur tejskrimeve të derisotme në filologjinë rumune, ku vërehet një prirje standartizimi në alfabetizimin e arumanishtes, përkatësisht të pasqyrit grafik të “sunete împrumutate din greacă” (Caragiu Marioțeanu 1968 6). Ndryshe operon Papahagi (1963) i cili përdor rëndom (në njësi leksikore jogreke) një grafemë të ngjashme me <g> (khs.: <virgină, virgiră>, f. 1112) që pasqyron shqiptimin e një mbylltoreje palatale, e cila gjason: “G : ca în it. *gheppio, gjirlanda, ghiaccia, ghiomo*, sau în fr. *guerre, gueule, guise*, sau în dr. *ghem, ghimpe, ghioaqă, ghium*.” (f. 45). Këtyre shembujve mund t’u shtohen fare mirë edhe gjegjëse shqip me mbylltoren palatale <g> [j]: geg. *virgjinë*; tosk. (e) *virgjërë* etj.

12 Informanti ynë për gjendjen gjuhësore aktuale të arumanishtes në hapësirën kompakte shqipfolëse, të cilit i shpreh përzemërsisht falënderimet e rastit, është folësi nativ dhe njohësi i patëmetë i arumanishtes Andon Kristo (70 vjeç, banor në Tiranë).

që bashkëbart rotacizimin e një \*-n-je ndërzanore të dikurshme në të folmet toske e për rrjedhojë dëshmon një interferencë të dukshme të këtyre të folmeve. (sh. Papahagi 1963 1112: *virgină, virgără* adj. “vierge” [...] < alban. *virgjër*). Interes të veçantë fiton me këtë rast vëzhgimi i Kahl-it (2006 248), sipas të cilit varianti i rotacizuar në arumanishte është një tregues dialektor i përhapjes së tij në veri të trevave arumanishtfolëse.<sup>13</sup>

- Marrëdhëniet *grafi – fon – fonemë* në tekstin arumanisht dëshmojnë të njëjtin orientim të autorit në kodin alfabetik të greqishtes së kohës, por që përdor sipas rastit edhe shkronja të veçanta që nuk i takojnë atij kod. Prashtu, ndeshim në tekst grafema njëshkronjëshe me vlerë njëfunktionale: khs.: <B β> = v, <ρ> = r, <ν> = n, <Μ μ> = m, <π> = p, <ε> = e, <λ> = l', <κ> = c (= [k]), <γ> (= [j] para [e, i] ?<sup>14</sup>); si edhe dyfunktionale, khs.: <τ> = t ~ d ose (?) <ι> = i ~ ã. Sikurse në tekstin shqip ndeshim edhe këtu ligaturën (gr.) <γ> = <ou> = /u/, krahas asaj për <τό> = to te *pecătoșli*, apo kombinime me mjete grafike, khs. <ï> = i = [i/j]. Të njëjtën vlerë funksionale dëshmojnë edhe variantet grafike (pa shpërndarje alografike në varg) <ή, ι> = i dhe <ώ, ó> = o që shfaqen si të tilla edhe në shkrimet e dorëshkrimet greqisht të kohës. Në tekst vërejmë gjithashtu paraqitjen grafike të zanores (së vetme) qendrore të arumanishtes [ə] (= ã) me jota <ι> në katër raste, krahas grafemës së huaj (lat.) <e> në vetëm një rast. Kjo zanore na shfaqet në tekst edhe në rrokje të patheksuar, por në përdorimin e dy varianteve grafike nuk bie në sy ndonjë shpërndarje alografike.

Krahas këtyre vëzhgimeve të natyrës grafike-funksionale lejohemi të shtojmë rishtas se në tekstin arumanisht feksin dy grafema të tjera, krejt të huaja për alfabetin e greqishtes, siç janë: <ħ> = ș (= [ʃ]) dhe <Λ> = (arum.) ğ (= [dz] ~ gr. <τζ>), të cilat përcjellin grafikisht tinguj me vlerë funksionale (fonema) që mungojnë në inventarin e fonemave të greqishtes.

- Përdorimi i dyshkronjështit <-οι> me vlerën fonetike funksionale /i/ = [i] si realizim i rregullt nyjëtimor i mbaresës emërore/kallëzore (të shquar) për shumësin e emrave mashkullorë në arumanishte përkon plotësisht me grafinë dhe nyjëtimin e mbaresës së shumësit të një klase të caktuar të emrave mashkullorë në shkrimin (tradicional) greqisht: (gr.) <-οι> = [-i]. Gjithsesi kjo përvojë – duke qenë disi e pazakonshme edhe në traditën e shkrimit arumanisht – ia vlen të këqyret më fort si çështje e natyrës grafike-gramatikore dhe jo në kuadrin e

13 Shfaqje arkaizmi dialektor dëshmon sipas Kahl-it (*loc. cit.*) edhe emri *pecătoșli* (= *pecătoșli* “mëkatarët”), i cili është zëvendësuar ndërkohë me greqizmin *amartoshli*. Shih edhe Kahl & Prifti 2016 40.

14 Shih më lart shën. 11.

marrëdhënieve *grafi ~ fon ~ fonemë*. Për këtë shmangie në interpretim lejohemi të rimarrim në analizë edhe tekstin shqip, ku – siç prekëm më lart (§ 3.1) – na shfaqet e njëjta rrethanë në fjalëformën e fundit me dyshkronjëshin <-oi>: <φαῖτόρετ-oi>. Edhe këtu ky dyshkronjësh përkon për nga funksioni gramatikor me mbaresën (emërore/kallëzore) të shumësit të emrave mashkullorë të tipit *fajtor-ë*; pra në rastin konkret pritej të shkruhej a shqiptohet prej një shqipfolësi nativ (të kohës) me zanoren qendrore të patheksuar -ë = [-ə].

Përderisa ky dyshkronjësh përfaqëson grafikisht në sistemin emëror të greqishtes mbaresën gjegjëse të shumësit {-oi} (= [-i]), atëherë kemi së paku të drejtë të shtrojmë pyetjen, se mos në të dyja tekstet shqip dhe arumanisht kemi të bëjmë thjesht dhe vetëm me një rimarrje automatike të grafisë së mbaresës së shumësit greqisht, por që lejon të lexohet në secilin tekst ndryshe: arum. {-i} vs. shq. {-ë}. Përndryshe mund të përsiasim si zgjidhje alternative që ky asociacion grafiko-logjik – më se i motivueshëm për tekstin arumanisht – të jetë përcjellë automatikisht edhe në tekstin shqip, pra si e ashtuquajtur “lajthitje” ortografike e autorit ase shkruarit arumun (Tërpos ?) të mbishkrimeve në gravurë.

- Sa i përket analizës leksiko-semantike dhe sintaksore të këtij teksti njëfjali arumanisht, kemi të bëjmë edhe në këtë rast me një fjali të thjeshtë dëshirore-nxitëse e me strukturë njëlloj si gjegjësja shqip, pra duke u plotësuar si subjekti ashtu edhe plotësi me dy ndajshtime: /virÿiră/ ← /mumă (al Dumneđă)/ pranë / (tre) noi/ ← /pecătoşli/.

#### **4 Marrëdhënie të ndërsjella në kulturat e shkrimit shqip dhe arumanisht në shek. XVIII**

Analizat e mësipërme filologjike dhe gjuhësore na mundësojnë të fokusohemi së pari në do tipare të përbashkëta që përcjellin dy tekstet shqip dhe arumanisht, të cilat jo në çdo rast arrijnë të shpjegohen lehtë me dhuntitë intelektuale dhe gjuhësore të njërit apo tjetrit autor, qoftë ky edhe Tërpo, i cili syzonte të përcillte kumtin e veprës së tij te besimtarët e thjeshtë ortodoksë. Këto përbashkësi të renditura më lart – ndër to sidomos vendi i tyre i parë në kohë në secilën kulturë (përkatesisht areal kulturor), siç i njohim gjer më sot – sendërtojnë një qerthull problemor të ngjashëm, sa i përket hetimit dhe rindërtimit tentativ të fazave të mëhershme në secilën traditë shkrimi. Për më tepër, kjo rrethanë shton edhe një temë të re në debatin e përbashkët historik-filologjik: Në ç’masë kanë a mund të kenë bashkëvepruar dhe interferuar këto tradita me ose në njëra-tjetrën?

Për këtë dritare të re në diskursin ndërdisiplinor i detyrohemi sigurisht Lloshit (2008), i cili pas analizës tekstore e filologjike të mbishkrimeve vjen në përfundimin se për (a) lutjen arumanisht e veçanërisht për (b) atë shqip:

a) “Kam bindjen se kjo ka qenë stilemë standarde fetare e arumanishtes.” (f. 297) dhe

b) “Te N. Tërpoja kemi një fjali shqipe të përkthyer jo nga greqishtja dhe jo nga latinishtja, por nga arumanishtja.” (f. 297)<sup>15</sup>

E më tej, lidhur me (c) alfabetin e tekstit shqip:

c) “Ndonëse është shumë pak për të dhënë një gjykim të sigurtë, për mendimin tim [alfabeti i tekstit shqip – B.D.] është një alfabet i greqishtes, i përshtatur nëpërmjet arumanishtes për shqipen, ku përzihet një shkronjë e rëndësishme latinisht, ndoshta edhe dy [= <e>, <j> – B.D.], por kjo nën ndikimin e alfabetit të arumanishtes aty, sepse po ashtu bëhet ai dallim *ë - e* [= <e> ~ <ε> – B.D.]; është po e njëjta shkronjë për ‘u’ [= <γ> – B.D.]. Ka të ngjarë që Tërpoja kishte përvojë me këtë alfabet dhe me shkrimin në të dyja gjuhët. Do ta përsëris se Tërpos meriton t’i vihet në dukje se ka bërë një përkthim mjaft të mirë nga arumanishtja, me një shqipe të shkruar jo si fillestar. Është një përkthim jo duke ndërtuar një fjali të shqipes nga gjuha e folur, jo duke ndjekur greqishten, por me një paratekst të shkruar arumanisht.” (f. 299)

**Shënim:** Duke i dalluar dukshëm këto përsiatje në formë rezultati shkencor, duam të tregojmë njëherësh respekt ndaj autorit që shkruan e boton në një mjedis kulturor-intelektual, i cili vuan ende pasojat e asaj dhune strukturore informale të politikës së dikurshme shkencore me orientim ideologjik-nacionalist dështak, bash ashtu siç e përjetojmë sot e gjithë ditën me dukurinë e “emilizimit” në diskursin shkencor-albanologjik zyrtar.<sup>16</sup>

Le të ndalemi në vijim më konkretisht në këto çështje të debatit ndërdisiplinor që syzon Lloshi më lart me synimin farëmirë me nxitur në të ardhmen ndërmarrje ndërdisiplinore të kësaj natyre.

#### 4.1 Lutja – stilemë standarde fetare arumanisht (?)

Lutjen në tekstin arumanisht lejohe mi ta gjykojmë në instancë të fundit edhe si “stilemë standarde fetare të arumanishtes” (Lloshi 2008 297), edhe pse mund të mos shquhej (dikur) për një denduri të konsiderueshme në mbarështimin e nomeve dhe zakoneve të jetës së përditshme në bashkësinë ortodokse arumune. Veçse me këtë rast do mbajtur gjithashtu parasysh se këtë lutje në thelbin e saj e ndeshim gjithkund të përhapur sidomos në orologun dhe liturgjinë e Kishës Perëndimore (Katolike-Romake, Anglikane etj.). Prashtu mjafton t’i anashkalojmë emrit të parë (: shq. *virgjinë* ~ arum. *virviră* = lat. *virgo, -inis*) e të mos bëjmë aspak çudi që kemi të bëjmë këtu me një pjesë të lutjes themelore “Ave Maria”, përkatësisht me shtojcën e saj,

15 Dhënë me markim të dyfishtë: kursiv dhe shkronja të zeza, prej vetë Lloshit [- B.D.]

16 Hollësisht për këtë dukuri negative në periudhën e tranzicionit intelektual shqiptar në Demiraj 2017 375vv.

që erdhi dhe u kanonizua në Kishën Katolike-Romake në vitin 1568 prej Papa Piu-t V<sup>17</sup>, khs.:

(lat.) Sancta Maria, *Mater Dei, ora pro nobis peccatoribus* nunc et in hora mortis nostrae.

(it.) Santa *Maria, Madre di Dio, prega per noi peccatori*, adesso e nell'ora della nostra morte;

(dt.) Heilige Maria, *Mutter Gottes bitte für uns Sünder*, heute und in der Stunde unseres Todes;

(angl.) Holy Mary, *Mother of God, pray for us sinners*, today and in the hour of our dead.

etj.

Parë nga kjo perspektivë kjo lutje (shtesë), në mos stileme, pritej e pritet të ishte e njohur dhe e përdorur shumë e më shumë në ato shtresa sociale të besimit të krishterë, që gjëllinin atëbotë kryesisht në Arealin Kulturor të Veriut e kryesisht ndër besimtarët e bashkësisë katolike shqiptare, sikurse edhe ndër arbëreshët e Italisë. Andaj nuk kemi përse bëjmë aspak çudi, që këtë lutje e hasim gjithkund këtë periudhë në përkthimet shqip, sidomos në ato të Doktrinës së Krishterë, khs.:

- /Sheinteja Mbrii, *e Ama e Tinezot, lutu për nee fajorët [...]*/ (Kazazi 1743 22)

- /Shejteja Mrii, *Ëma e sin Zot, lut për nee të mukatruamit [...]*/ (Figlia 1736 5r)

Asgjëmangut, kjo traditë kishte zënë rrënjë mot-moti ndër shqiptarët katolikë të Veriut sikurse edhe tek arbëreshët e Italisë, bash ashtu siç na e dëshmojnë përmendoret shqip të shekujve të mëparshëm, khs.:

- /[...] Shënmëri, *Ëma e Tinëzot parakales për në të mkatëruamit nani e nd' orët të morsë sanë.*/ (Matranga 1592 dsh.A 21v)

- /Shinteja Mërii, *Ama e Tinëzot , lutu për nee fajëtorët*, tashti e ndë horë^të morsë sanë/ (Budi DC 1618 51)

- /Zotnja e Shënë Mërii, *Virgjëna e beekuome; lutu për muo fajëtuorrë, o hiirplota!*/ (Budi RR 1621 151)<sup>18</sup>

Viti i botimit/hartimit (1555) është një tregues i qartë, përse këtë pjesë lutjeje nuk e hasim në „Mesharin” e Gjon Buzukut. Gjithsesi modeli i saj është i kudogjendur në këtë vepër, khs.:

- /[...] *Shenjteja Mëri, lutu për në. Shenjteja qi Tenëzonë leve, lutu për në. Shenjteja Virgjënë përëmbi gjithë virgjënatë, lutu për në.*/ (Buzuku 1555 180ra)

Pa dashur, madje pa qenë as në gjendje ta ndjekim këtë çështje në rrafshin dokumentar-historik dhe liturgjik-kishtar në Arealin Kulturor

17 Courth 1996 526vv.

18 Shembulli i fundit është një dëshmi e qartë e dëndurisë së përdorimit rëndom – pra edhe me “shmangie” – të kësaj lutjeje në Arealin Kulturor të Veriut katolik shqiptar.



Ortodoks, meqë „shtojcën” e kësaj lutjeje nuk e ndeshim gjëkund në përmendoret e tjera shqip dhe arumanisht të shek. XVIII (Kavalioti 1770, Daniel [1794 ~] 1802),<sup>19</sup> detyrohemi të vijojmë përsiatjet tona duke u përqendruar në do pamje të natyrës kryesisht filologjike dhe kulturore-historike. Prashtu, mendojmë që hapi i dytë që duhet bërë në hetimin e një interference të mundshme midis dy përkthimeve të tekstit, është përdorimi paralel i fjalëformave foljore: arum. *oră* kundrejt shq. *uro* në bashkëlidhje me gjegjësen burimore lat. *ora* në lutjen në fjalë, që erdhi e u kanonizua si e tillë në liturgjinë dhe librin e orëve të Kishës Perëndimore. Këtu lejohemi tash të këqyrim edhe përsiatjen e Lloshit, i cili vë në dukje se në këto mbishkrime fjalëforma arum *oră* (2nj.urdh.) “(angl.) pray; please” duhet të jetë një përdorim i rregullt leksiko-semantik i kësaj foljeje në arumanishte, d.m.th krejt ndryshe prej gjegjëses shq. *uro*(!), për të cilën përdorimi me kuptimin “pray; please!” është në kohën tonë disi i pazakonshëm, kundrejt të zakonshmit “wish”. Kështu, sipas tij: “Më domethënëse është folja *uro*. Ajo është e njëjta fjalë në tekstin arumanisht [: *oră* – B.D.] dhe shqip e me të njëjtin kuptim sot. Ne e përdorim me tjetër kuptim sot, por Tërpoja e ka marrë se ashtu mund të thuhet shqip, meqë edhe *běj uratë* do të thotë *lutem*.” (Lloshi 2008 298)<sup>20</sup>

Le të pjesëmarrim në debat duke vënë përballë përsiatjes së Lloshit një tjetër zgjidhje alternative: Mos kemi të bëjmë vallë në tekstet arumanisht dhe shqip me një ndërhyrje individuale të autorit – në mos të censorëve (?) –, i cili më fort se sa një model greqisht ndjek aty gjegjësin latinisht? Kjo pyetje në formë përsiatjeje të dytë shfaqet natyrshëm, në rast se mbajmë parasysh, ndër të tjera, që edhe arum. *oră* sikurse shq. *uro* dëshmojnë vetëm në Gravurën e Ardenicës, pra vetëm një herë në bashkëlidhje me lutjen në fjalë. Dhe është fakt që kjo lutje mund të përdoret ndoshta rëndom, qoftë edhe si stilemë (edhe) ndër folësit e sotëm nativë të arumanishtes në Jug të Shqipërisë, veçse në këtë rast do të parapëlqehet gjithkund folja *plăcărseu* (: me metatezë prej *părăcălșeu, părăcălșescu*<sup>21</sup>) < gr.: παρακαλῶ „id.”; njëlloj si në dëshminë e kryehershme të kulturës së shkrimit shqip me traditën e ritit bizantin (khs. më lart Matranga 1592: *parakales*). Ndryshe nga tradita arumune, në rumanishte do të ndeshnim më fort foljen sinonime latine *a se ruga* (< lat. *rogāre*), në mos *a se închina* „falem” khs.:

19 Një variant të kësaj lutjeje – sigurisht pa “shtojcën” në fjalë – kemi mundur ta izolojmë në tekstin e Kodikut të (Kostë) Beratit (fondi i shek. XVIII: sh. më poshtë § 4.2.2), të cilën po ia përcjellim lexuesit të transkriptuar, si vijon: /Mëme e Perëndisë, e virgjira, gëzohu o e gëzuashme Marinë, se Zoti me ty. E bekuarë je ti ndë mes të gravet e i bekuarë hyshyr i barkut tënt, se shpëtim linde për shpirtërat tanë./ (KB 26 14-22)

20 Për spektrin kuptimor të kësaj foljeje dhe çerdhen e saj leksikore në kohën tonë, shih FGJSSH (1981 2094): “shpreh dëshirë, përgëzoi; bised. jap uratën, bekoj.”

21 Këtë formë e ndeshim te Papahagi (1963 827)

- (arum.) Stă Mării, *muma a Hristolu, plăcărsea ti noi, păcătoșii...*<sup>22</sup>
- (rum.) Sfânta Maria, *Mamă a Domnului, roagă-te pentru noi, păcătoșii...* (~ *Fecioară, Maică a Domnului, roagă-te pentru noi, păcătoșii...*) etj.<sup>23</sup>

Përsiatjen tonë në formë pyetje e mbështet deri diku edhe spektri kuptimor i arum. *aor* “souhaiter”, or “prier; souhaiter, féliciter” (Papahagi 1963 115; 807v), folje e cila ka përjetuar pas gjase të njëjtin fat sikurse shq. *uroj*, meqë së paku në kohën tonë në radiusin e përdorimit të saj leksiko-semantik mbizotëron kuptimi “uroj dikë për diçka, përgëzoj”, ndërkohë që ndërtimi emëror përkatës arum. *oară* f. përdoret sot vetëm me kuptimin “urim”<sup>24</sup>, pra ndryshe nga shq. *uratë* f., që ruan ende kuptimin burimor “lutje”, khs. *bëj uratë* “lutem”, (i) *jap uratën (dikujt)* “bekoj” (FGJSSH 1981 2094). Sa u përket rrethanave që na ofron kultura e mëhershme e shkrimit shqip, jemi objektivist të detyruar të citojmë edhe në këtë rast dëshmi të sigurta vetëm prej Arealit Kulturor të Veriut, ku vërehet se si përdorimi i foljes *uroj* me kuptimet “pray; please” krahas “wish”, vjen e humbet gjithnjë e më shumë konkurrencën me foljet *lus, lutem* “please; pray” dhe *falem* “pray; please” khs.:

- /Vëllazënë, na nukë pushojmë *tue ȳruom* Tinëzot për jū [...]/ (Buzuku 820rb) kundrejt: /[...] tash u *jam ënfalë* gjithëve, e *lutëni* tenë Zonë ende për muo./ (Buzuku 110rb)

- /[...] e mos u vinjë fështir *me uruem* për mue./ (Bardhi 1635 Vr) kundrejt: /Orare Deum : *me lutunë* Tënëzonë/ (80)

Janë këto argumente pozitive që përcollëm më lart, të cilat i venë në dyshim përfundimet e Lloshit (§ 4 a/b), madje i japin një orientim të përkundërt hetimit të burimit të mbishkrimeve në gravurë, ku si model fillestar – ndryshe nga ç’përsiat Lloshi – nuk mund a duhet të ketë shërbyer patjetër greqishtja, e aq më pak arumanishtja, se sa vetë gjegjësjat latine e lutjes, ku feks jo rastësisht fjalëforma *ora* e foljes lat. *orāre* “pray; please”, e cila është edhe burimi i natyrshëm etimologjik i gjegjëseve arumanisht dhe shqip.

Nga sa u tha më lart, si zgjidhje të paktën alternative duhet mendur paraprakisht për një ndërhyrje të ndërgjegjshme, qoftë edhe të natyrës stilistike nga ana e vetë autorit (me formim të plotë intelektual-fetar: Tërpos ?) në njërin a tjetrin mbishkrim të gravurës,<sup>25</sup> njëlloj siç u përsiat

22 Informant: Andon Kristo (sh. më lart shën. 12).

23 Shkruesi i këtyre radhëve i detyrohet shumë koleges Cătălina Vătășescu për konsultimin me vlerë për këta shembuj.

24 Informant: Andon Kristo (sh. më lart shën. 12).

25 Nuk jemi në gjendje gjithashtu të gjykojmë lidhur me atë qerthull problemor potencial të përdorimit të foljes (lat.) *orāre* sa i përket kumtit të nocioneve ‘please’ vs. ‘pray’ në aspektin teologjik, përkatësisht në përdorimin e saj polisemik, shpesh herë kontradiktor në liturgjinë kristiane, një rrethanë kjo që duket të jetë transponuar në një mënyrë a një tjetër me foljet gjegjëse në gjuhë të ndryshme liturgjike, khs. it. *pregare*, fr. *prier*, rum. *a*

më lart për një ndërhyrje apo “lajthitje” po aq të vetëdijshme të natyrës grafike-gramatikore, ku mbaresat e njëjta të shumësit arum./shq. <-oi> përkoinë jo rastësisht me gëgjësen greqisht <-oi> edhe pse shqiptimi në shqip pas gjase rezulton të jetë i ndryshëm për lutjen shqip. Se në ç’masë këto variante pas gjase diturake të lutjes shqip dhe arumanisht, bash ashtu siç i lexojmë në Gravurën e Ardenicës, mund të jenë përdorur dikur në bashkësinë multietnike ortodokse në Arealin Kulturor të Jugut, shi aty ku vepronte atëbotë murgu Tërpo, është edhe kjo një çështje, të cilën nuk jemi në gjendje sot për sot ta zgjidhim me fakte dhe forcë argumenti. Dhe arsyeja në aspektin filologjik është e thjeshtë: Lutja si e tillë nuk dëshmohet më përgjatë gjithë shek. XVIII në përmendoret e hershme që njohim deri sot në kulturën e shkrimit shqip dhe arumanisht në Arealin Kulturor Ortodoks të hapësirës shqipfolëse.<sup>26</sup>

#### 4.2 Marrëdhënie të ndërsjella në sistemet grafike shqip dhe arumanisht në shek. XVIII

Gravura e Ardenicës mund të cilësohet me të drejtë si gur sinori për ndërmarrje studimesh të natyrës ndërdisiplinore lidhur me historinë e

---

*se ruga, a se ñnchina, shq. lus, lutem dhe falem kundrejt angl. please vs. pray, gjerm. bitten „please“ vs. beten „pray“, sikurse, madje në rastin tonë sidomos (gr.) προσευχή „pray“ pranë παρακαλώ „please“. Pas gjase nuk është rastësi që në liturgjinë ortodokse greke do të parapëlqehet (sot) folja προσευχή „pray“, khs.: Μητέρα του Θεού, προσευχηθείτε για μας τους αμαρτωλούς τώρα και κατά την ώρα του θανάτου μας (kundrejt asaj në arumanisht që vijon gr. παρακαλώ: sh. më lart). Një rrethanë të ngjashme përjetojmë edhe në liturgjinë ortodokse ruse (старообрядцы), ku hasim të dyja variantet: a) Пресвятая Госпоже Богородице моли Бога о нас kundrejt Пресвятая Госпоже Богородице услыши молитву раб своих молящихся Тебе. Duhet të përmendim këtu edhe problemet që mund a duhet të ketë hasur Fan S. Noli në përgatitjen e teksteve liturgjike ortodokse shqip, kur parapëqen së fundi në këtë kontekst krahas *lutem* edhe foljen *ndërmjetësoj*, khs.: /Nën’ e Shpëtimtarit o Shën Marí. Prit-i lutjet tona, të pavýera dhempshërisht, *lutju* pa pushuar, atí që e ke lindur o Zonj’ e tërë botës, *ti nërmjetó për né.* / (1947 67) Për këtë dëshmi gjuhësore stilistike në veprën e Nolit autori falenderon përzemërsisht At Foti Cicin, Thoma Qendron, Dhori Qiriazin, Aleksander Novik-un dhe *last but not least* mikun e tij të shtrenjtë, vëllamadhin Titos Jochalas.*

- 26 Dëshmitë gjuhësore për foljen, përkatësisht veprimin a nocionin në fjalë (: ‚pray’ vs. ‚please’) ose mungojnë, ose dëshmojnë të kundërtën. Kështu p.sh.: te Kavalioti (1774) nuk ndeshim fare të regjistruar këtë folje apo sinonime të saj në shqip dhe arumanisht. Te Danieli ndeshim në dy raste të sigurta vetëm foljen *lutem*, e cila i pranëvihet gëgjëses arumune të zonës përreth, si vijim i natyrshëm i gr. παρακαλώ, khs. 1) gr. <[... ] να παρακαλή> : arum. <τρά σε παρακράσιασκα = /tra se pälacräsia|ska/ : shq. <κῆ τῆ λιούτετ> = /qi të lutet/ (v[argu] 214); krahas 2) gr. <καὶ να τὸν παρακαλοῦεν> : arum. <σση̄ σελουπαλακρασίου> = /si se (lu ?) pälacrasimu/ : shq. <έδέ τά λιούτεμι> = /edhe të lutemi/ (v. 445). Në një rast të tretë dhe të fundit proporcionet janë krejt të paqarta, khs.: gr. <Ὁ πόταν εορτάζης | εἶναι καλά> : shq. <κούρ λιούτεσφεστών ἔστα μήρα> = /Kur lutesh=feston është mirë/ : arum. <Κάντου γιουρουσέστη ἔστε γκήνε> = /cändu γuruséshti este γine/ (v. 1065)

kulturës së shkrimit shqip me alfabet grek, sidomos në zonën jugore të Shqipërisë së Mesme dhe në jug të saj (me qendra kryesore urbane Elbasan, Voskopojë, Ohër), një zonë kjo historikisht e njohur për bashkëjetesën, përkatësisht përballjet ndërmjet besimeve, konfesioneve deri edhe varianteve të ndryshme brenda një konfesionit, siç janë: Krishterimi ~ Islami, Kisha Katolike-Romake ~ Kisha Ortodokse; Kisha Metropolitane e Ohrit ~ Patrikana e Stambollit. Parë nga perspektiva e kulturës së shkrimit shqip ky peisazh i larmishëm kulturor-fetar sendërtohet më së miri në përmendoret shqip të kësaj periudhe (shek. XVIII), ku konkurrojnë njëri-tjetrin shkrimet shqip me bazë kodet alfabetike greqisht, latinisht-italisht, arabisht, sikurse edhe syresh me alfabete origjinale e deri tek ai qirilik.

Këtij mjedisi kulturor (jo) të zakonshëm që ruan e gëzon sot e gjithë ditën statusin e Nyjës së Gordonit në historinë e kulturës së shkrimit shqip, Lloshi i shton në studimin e sipërpërmendur një komponent të ri, shi atë të kulturës së shkrimit arumanisht, pas gjase me shpresë se do të mund të zgjidhë së paku një hallkë të saj, bash atë traditë të shkrimit shqip me alfabet grek. Kështu, siç cituam të plotë përsiatjen e tij më lart (§ 4): “Ndonëse është shumë pak për të dhënë një gjykim të sigurtë, për mendimin tim, [alfabeti i tekstit shqip – B.D.] [...] është një alfabet i greqishtes, i përshtatur nëpërmjet arumanishtes për shqipen, ku përzihet një shkronjë e rëndësishme latinisht, ndoshta edhe dy[...] Ka të ngjarë që Tërpoja kishte përvojë me këtë alfabet dhe me shkrimin në të dyja gjuhët. [...]” (Lloshi 2008 299)

Asgjëmangut, të dhënat e këtij teksti njëfjali me gjithë-gjithë 7 njësi leksiko-sintaksore janë “shumë pak për të dhënë një gjykim të sigurtë”, andaj kemi tash të drejtë që, përpos përpjekjes me verifikuar përsiatjen e Lloshit, të mund të syzojmë edhe ndonjë zgjidhje alternative, sa i përket interferimit ose konvergjencës potenciale të njëres ose tjetres traditë shkrimi në dhe me njëra-tjetrën, duke mbajtur këtu parasysh sigurisht edhe mjedisin e larmishëm kulturor-gjuhësor të besimit ortodoks në këtë zonë.

Nisur nga kjo premisë metodike lejohemi të theksojmë rishtas që në bazë të këtyre dy teksteve qëndron kodi alfabetik me rregullat e leximit të greqishtes së re. E ky kod e këto rregulla rrokin së pari të gjitha grafemat e veçanta dhe alografet me vlerë njëfunktionale që dëshmohen ose së bashku në dy tekstet, ose veç e veç në njërin syresh, por që përdoren rëndom si të tilla në greqishte, si p.sh:

- arum./shq.: <α> = a, <β> = v, <ρ> = r, <ν> = n, <Μ μ> = m, <π> = p, <ε> = e, <λ> = /l/, <γ> = γ (= [j] ~ gr. <γ> para [e, i]), <ω, ο> = o, (ligatura) <γ> (= <ου>) = u
- arum.: <κ> = c (= [k]), sikurse ligatura për gr. <το> = to
- shq.: <σ> = s, <η, ι, η> = i, <τ> = t (krahas <ντ> = nd)

Në këtë klasë mund të ndërkalim edhe do grafema të përbashkëta me vlerë njëfunktionale (fonetike-gramatikore) që mund të përcjellin shmangie të rastit ndaj rregullave të leximit greqisht e që rezultojnë si kombinime dyshkronjëshe: gr. <-οι> = arum. -i (= gr. [-i]) ~ shq. (?) -ë; gr. <γκ> = shq. *gj*; sikurse edhe përdorimi i një shkronje me mjet grafik: gr. <ϊ> = arum./shq. *i/j* (= [j]).

Në përdorimin e grafemave të huaja për kodin alfabetik të greqishtes të dyja tekstet i bashkon me njëri-tjetrin vetëm përdorimi i lat.-it. <e> = arum. *ǣ* : shq. *ë* (= [ə]). Që vetëm teksti arumanisht dëshmon edhe dy grafema të tjera, të cilat rezultojnë të huaja për kodin alfabetik të greqishtes, khs.: <lh> = *ş* (= [ʃ]) dhe <λ> = (arum.) *đ* (= [dz]), këtë fakt lejohe mi ta klasifikojmë përkohësisht si një rastësi e mirëseardhur jo vetëm në hetimin e kulturës së shkrimit arumanisht, meqë nuk parakupton aspak mungesën e tyre atëbotë në kulturën e shkrimit shqip, përkatësisht mosnjohjen e tyre prej autorit arumanisht- dhe shqipshkrues. (sh. § 4.2.2)

Shmangie sado të rastësishme ndaj njëri-tjetrit përcjellin mbishkrimet në fjalë në përzgjedhjen e ndonjë varianti grafik, siç është p.sh. shkrimi me shkronjë të madhe i *beta-s* (~ *vita-s*) gr. <B> (= [v]) që në mbishkrimin arumanisht shfaqet si grafemë majuskël e rregullt e greqishtes, ndërsa në gjegjësin shqip sipas Shuteriqit “është identike me gërmën *v* të alfabetit origjinal të shqipes, që gjejmë te [Kodiku i] *Kostë Berati*.” (1952 14; 1976 107) e me të cilën do të merremi hollësisht më poshtë (§ 4.2.2). Nuk mund të lëmë jashtë vëmendjes edhe përdorimin e variantit grafik (minuskël) të *eta-s* (~ *ita-s*) gr. <η> krahas <η> (= [i]) vetëm në mbishkrimin shqip.

Nga kjo përjasje paraprake e dy teksteve lejohe mi të përfundojmë paraprakisht që, lidhur me marrëdhëniet *grafi* ~ *fon* ~ *fonemë*, vërejmë një stabilitet më të lartë të kodit alfabetik në tekstin shqip kundrejt atij arumanisht, çka i bie ndesh deri diku përfundimit të Lloshit se ky kod është “një alfabet i greqishtes, i përshtatur nëpërmjet arumanishtes për shqipen” (§ 4c). Sigurisht që kumtojmë këtu thjesht një përshtypje të parë, meqë vetëm në tekstin e shkurtër arumanisht na shfaqen lëkundje përdorimi me vlerë dyfunktionale të ndonjë grafeme, si p.sh.: arum. <τ> = *t* vs. *d*, por sidomos *jota* arum. <ι> = *i* vs. *ǣ*, e cila shkakton kolizion largvajtës në përdorimin e grafemave/alografeve me vlera të ndryshme njëfunktionale, khs.: arum. <η> = *i* vs. <e> = *ǣ*.

#### 4.2.1 Përjasje sistemesh grafike mes tekstesh arumanisht dhe shqip në shek. XVIII

Përmendore të tjera shkrimore me alfabet grek dhe tekste paralele shqip dhe arumanisht (krahas sosh greqisht dhe bullgarisht-maqedonisht) që datohen në shek. XVIII i hasim në trevat jugore të Arealit Kulturor Ortodoks te dy autorë voskopojarë të mëvonshëm me origjinë pas gjase arumune:

Anastas Kavalioti (1770) dhe Daniel Voskopojari ([1796 ~] 1802). Në fakt – siç përmendëm më lart – në asnjërin syresh nuk e ndeshim lutjen në fjalë (sikurse edhe vetë foljen arum. *or, aor* “lus, lutem; uroj, përgëzoj”<sup>27</sup>), kështu që ngërthimi i tyre në studimin tonë fiton interes, në rast se fokusohemi si të thuash vetëm në kodet alfabetike të shkrimeve shqip dhe arumanisht që përcjellin këto tekste. Parë nga kjo perspektivë lejohemi të vërejmë së pari që teksti, përkatësisht autori i dytë (Danieli) vijon me besnikëri të parin (Kavaliotin), ndërsa dallimet e tyre me mbishkrimet në Gravurën e Ardenicës janë sa të dukshme aq edhe cilësore. Prashtu në tekstet e Kavaliotit feks një prirje e theksuar “purifikimi” e kodit alfabetik të arumanishtes, përkatësisht atij të shqipes, të cilët bazohen kryekëput në inventarin e shkronjave me kombinimet përkatëse (me shkronja e mjete grafike) që disponon alfabeti grek së bashku me rregullat e leximit të greqishtes. Ky kriter ortografik rrok, ndër të tjera, të ashtuquajturat grafema të huaja që ngjerojmë në mbishkrimet arumanisht dhe një (më saktë dy – sh. § 4.2.2) shqip në Gravurën e Ardenicës, khs.: <e> vs. (Kavalioti) <α> (= [ə]), <h> vs. (Kavalioti) <σς, σσ> (= [ʃ]) dhe <λ> vs. (Kavalioti) <τζ> (= [ts ~ dz]) etj.

Meqë këto “risi” në kodin grafik të arumanishtes i përjetojmë edhe në gjegjësin shqip në veprën e Kavaliotit (sikurse edhe te Danieli), është vështirë të shtojmë ose të zbresim numrin e pikëpyetjeve në përsiatjen e Lloshit, sipas të cilit Kavalioti “ka gjetur zgjidhje për arumanishten dhe i ka ndjekur në vijimësi edhe për shqipen.” (2008 290). Vargu i pikëpyetjeve mbetet gjithsesi i hapur në rastin tonë të studimit me mbishkrimet shqip dhe arumanisht në gravurë, të përfutuara pas gjithë gjasash në të tjera rrethana që dallojnë a) në kohë: gjysma e parë e shek. XVIII dhe b) në hapësirë: në treva më veriore të Arealit Kulturor Ortodoks. A duhet të përsiasim edhe në këtë rast si të mirëqenë një ndërhyrje të vetëdijshme të një autori arumun (Tërpo ?), i cili vjen e përshtat natyrshëm një kod alfabetik potencial të arumanishtes me hedhur në letër edhe kumtin gjegjës shqip? Modeli i përdorur prej Kavaliotit dhe i ndjekur besnikërisht prej Danielit – si autorë me origjinë arumune!!! – e bën potencialisht të mundshëm këtë opsion; veçse ky nuk do vështruar patjetër si e vetmja zgjidhje alternative. Siç vumë në dukje më lart (§4), këtë përsiatje të Lloshit e lëkund dukshëm variacioni grafik në tekstin arumanisht, që përcjell si faktor domino një kolizion vlerash funksionale mes grafemash, sidomos sosh të fonemave zanore: /e/ ~ /ə/ ~ /i/. Përndryshe nuk vërejmë një të tillë në tekstin po aq të shkurtër shqip.

#### 4.2.2 Përjasje sistemesh grafike me tekste shqip në shek. XVIII

Një tekst tjetër, më saktë një tog tekstesh që i përkasin kulturës ortodokse të shkrimit shqip në gjysmën e dytë të shek. XVIII na lejon së

27 Sh. më lart shën. 25.

paku të përsiasim si zgjidhje alternative që kodit grafik i lutjes shqip (dhe arumanisht) në Gravurën e Ardenicës të gëzonte me kohë dhe ndërkohë një përhapje të konsiderueshme sidomos në trevat veriore të Arealit Kulturor Ortodoks. Bëjmë fjalë këtu për të ashtuquajturin Kodik i (Kostë) Beratit (= KB), një lloj almanaku që përmban tekste gjithfarësh shqip (dhe greqisht), të cilët janë hedhur në letër pas gjase në Berat prej më shumë se një autori e përgjatë një periudhe bukur të gjatë: vitet 1764 – 1798.<sup>28</sup> Në tekste të veçanta (psalme, lutje, histori apostujsh) dhe glosarë dygjuhësh (greqisht – shqip) me alfabet grek të këtij kodiku ngjërojmë sipas rastit thaujse të njëjtat pamje të kodit alfabetik që përjetojmë në Gravurën e Ardenicës, ndër të tjera:


- a) në disa tekste po atë qëndrueshmëri në kodim sikurse lutja shqip në gravurë;
- b) në tekste të ndryshme po atë variacion grafik, së paku për zanoren qendrore /ə/ që ndeshim në lutjen gjegjëse arumanisht (khs.: <e> dhe <ı>); por shumë më shpesh
- c) një larmi edhe më të madhe variacioni grafik, sidomos në bashkëlidhje me këtë zanore (khs. <e>, <ı>, <ı>, <η>, <ξ>, <α>); ndërsa
- d) vetëm në një glosar të shkurtër greqisht-shqip ndeshim edhe kodin alfabetik në fjalorin trigjuhësh të Kavaliotit, prej të cilit janë kopjuar pas gjase një numër i konsiderueshëm lemash (KB 71-72).
- e) Sigurisht që do të ishim të paplotë, sikur t'i anashkalonim edhe një teksti njëfjali (f. 104) me kod të veçantë grafik që jet në Kodikun e Beratit, të cilin po e marrim më poshtë në shqyrtim në bashkëlidhje me çështjen e burimit të grafemave të huaja (jolatine) në Gravurën e Ardenicës.

Bëjmë fjalë për kodimin grafik të shqipes me një alfabet origjinal (KB 106), ku secila grafemë (e huaj) shoqërohet me një shembull shqip me alfabetin e zakonshëm grek të vetë kodikut.<sup>29</sup> Për një bashkëlidhje të parë midis këtij alfabeti dhe atij të tekstit shqip në Gravurën e Ardenicës i detyrohemi së pari vëzhgimit të mprehtë të Shuteriqit (1952 14), i cili, siç përmendëm edhe më lart, sinjalizon përpos zbulimit të vet edhe se: “Incialja V [= <B(ήργκηve)> = *virgjinë* – B.D.] është identike me gërmën v të alfabetit origjinal të shqipes, që gjejmë te *K[ostë] Berati*.” (1976 107). Kështu mjafton një përjasje e thjeshtë e këtyre dy grafive në faksimilet përkatëse për t’iu bashkuar pa mëdyshje këtij konstatimi, khs. (Kodikun i Beratit) <B> : <βαρ> = *var* “varr”.

28 Hollësisht Hetzer 1981, 1981/2, 1982a, 1982b, 1984.

29 I vetmi tekst shqip që njohim deri sot me këtë alfabet origjinal është një lutje sa e ngjashme aq edhe domethënëse në këtë kodik për Shënmërinë, të cilën po e japim të transkriptuar, si vijon: /Perëndilemea, shpresë e gjithë të kështerëvet, mbulo e ruaj e shpëto ata që shprenjënë mbë ty!/ (KB 104)

Është pikërisht ky bashkëpërkim, pas gjase jo i rastësishëm, që na nxititi të përdorim lupën e filologut, duke u thelluar në përjasjen mes dy faksimileve. Dhe gjetje të tjera pozitive u bënë më se të dukshme, veçse në kahe të përkundërt, meqë edhe dy grafemat e huaja (jolatine) të tekstit arumanisht përkujnë me simotra të vetat të ky alfabet origjinal: b) <lh> (= [ʃ]) : <σσέχ> = *sheh*; c) <Δ> (= [ts ~ dz]) : <τζά> = *ca* “disa”, khs.:



## 5. Përfundim

Përjasjet e mësipërme mes sistemesh grafike që qarkullonin atëbotë në kulturën e shkrimit shqip dhe arumanisht në Arealin Kulturor Ortodoks brenda hapësirës kompakte shqipfolëse na mundësuan të ezauronim thujse plotësisht atë qerthull problemor që ngërthen mirëfilli analiza filologjike e mbishkrimeve shqip dhe arumanisht në Gravurën së Ardenicës (§§ 3-3.2). Njohjen dhe shtjellimin e do shmangieve në kodin e përbashkët grafik me bazë alfabetin grek (§§ 4.2-4.2.1), i shoqëroi hetimi i burimit të grafemave të huaja për atë alfabet, të cilat rezultojnë të jenë sipas rastit huazime të gatshme qoftë prej alfabetit latin, qoftë edhe – madje sidomos – prej një kodi grafik me alfabet origjinal, i cili pas gjase jo rastësisht shërben si gurrë e përbashkët në kulturat e shkrimit të të dyja gjuhëve (§ 4.2.2).

Asgjëmangut, këto rezultate të fituara në bazë të analizave filologjike e bëjnë po aq të vështirë, në mos të pamundur, përdorimin si argumente pozitive ase negative me tumirur për periudhën në fjalë tezën paksa të nxituar lidhur me interferimin e kulturës së shkrimit arumanisht në atë shqip (apo anasjelltas ?) në Arealin Kulturor Ortodoks të hapësirës shqipfolëse. Përforcojmë kështu edhe nga kjo perspektivë atë përfundim që kumtuam më sipër për vetë lutjen në fjalë, së cilës i përkushtuam brenda mundësive që lejon një studim i kësaj natyre, një analizë të detajuar gjuhësore e kulturore-tekstologjike (§§ 4-4.1)

Vijmë kështu natyrshëm në mbyllje të studimit tonë me shpresën se mundëm të hidhnim në letër atë synim që i vumë vetes mirëfilli: të pjesëmarrim në mënyrë aktive në atë diskurs ndërdisiplinor që ndërmoi i pari Xhevat Lloshi (2008) lidhur me analizën filologjike dhe kulturore-historike të teksteve paralele shqip-arumanisht në Arealin Kulturor Ortodoks në jug të hapësirës shqipfolëse. Prashtu, Gravura e Ardenicës mund të cilësohet pa mëdyshje si dëshmitar okular i atij mozaiku gjuhësor-kulturor (§§ 2-2.2.3) në një zonë historikisht të njohur për bashkëjetesën ndër-etnike e ndërkonfesionale. Është kjo një zonë që sendërton Nyjën e Gordonit në historinë e kulturës së shkrimit shqip, e cila mund të



zgjidhet dhe do zgjidhur në bashkëvjajtje me njohjen dhe studimin e këtij komponenti sa të ri aq edhe të hershëm të saj: shi të kulturës së shkrimit arumanisht në Arealin Kulturor Ortodoks brenda hapësirës shqipfolëse.<sup>30</sup>

## BIBLIOGRAFI

### A. Burime

- Berati, Kostandin: Kodiku i Kostë Beratit (1764-1798) (drsh. – BKSJ)
- Budi, Peter: Dottrina Christiana. Compofta per ordine della fel.me. di Papa Clemente VIII. Dal R. P. Roberto Bellarmino Sacerdote della Compania di Giesv. Adejfo Cardinale di fanta Chiesa del Titolo di S. Maria in Via. Tradotta in lingua Albanese dal Rever. Don Pietro Bvdi da Pietra Bianca. In Roma. Per Bartolomeo Zannetti. 1618. (Con licenza de' svperiori.)
- Budi, Peter: Ritvale Romanum et Specvlum Confessionis[...]; parte I: „Ritvale Romanum” Romæ 1621
- Bardhi, Frang (= Franciscus Blanchus): Dictionarium latino-epiroticum[...], Romæ 1635
- Figlia, Nicolò: I Krishteu i Arbresh (1736 – drsh.: sh. më poshtë Mandalà, Matteo)
- Buzuku, Johannes: “Missale” (titull dhe vendi i botimit i panjohur – sh. më poshtë Çabej 1968)
- Kavalioti, T. A. (~ Theodōros Anastasios Kaballiotēs): “ΠΡΩΤΟΠΕΙΡΙΑ παρά τοῦ σοφολογιωτάτου καί αἰδεσιμωτάτου Διασκάλου Ἱεροκήρυκος, καί Πρωτοπαπᾶ Κυρίου ΘΕΟΔΩΡΟΥ ΑΝΑΣΤΑΣΙΟΥ ΚΑΒΑΛΛΙΩΤΟΥ ΤΟΥ ΜΟΣΧΟΠΟΛΙΤΟΥ ΕΥΝΤΕΘΕΙΣΑ.” ΕΝΕΤΙΗΣΙΝ 1770 [= /Prōtopeiria para tou sophologiōtatu/, Venedig 1770]
- Kazazi, Gjon P. N. (~ Johannes B. Niccolouich Casasi): Breve compendio della Dottrina Christiana. Tradotta in lingua albanese per l'utilità, e istruzione dei Fanciulli di questa Nazione. Da un Nazionale del Regno di Servia. Allunno della S. Congregazione. In Roma MDCCXLIII. in Roma [1743]
- Matranga, Luca: E mbsuame e kræshteræ. Bææra per tæ Vrtænæ Atæ Ladefmæ fciochiæriet Iefufit [...] Dottrina Christiana. Composta dal Reurendo P. Dottor Ledefma della Compania di Giesù. Tradotta di lingua Italiana nell' Albanese per Luca Matranga alumno del Collegio Greco, in Roma. In Roma preffo Guglielmo Facciotto 1592

---

30 Ky studim është një variant i zgjeruar me plotësim të rastit i një shkrimi në rumanisht kushtuar albanologut të njohur rumun Grigore Brâncuș me rastin e 90-vjetorit të lindjes.

- Daniel ( ~ Daniel Voskorojari): Δανιήλ Μοσχοπολίτης ΕΙΣΑΓΩΓΙΚΗ ΔΙΔΑΣΚΑΛΙΑ Περιέχουσα Λεξικόν Τετράγλωσσον τῶν τεσσάρων κοινῶν Διαλέκτων ἤτοι τῆς ἀπλῆς Ρωμαϊκῆς, τῆς ἐν Μοισίᾳ Βλαχικῆς, τῆς Βουλγαρικῆς, καί τῆς Ἀλβανικῆς“ [1802]
- Noli, Fan S.: Krentore e Kishës Orthodoxke. Boston, Mass. 1947
- Tërpo, Nektar (~ Τέρπος, Νεκτάριος, Tärpu, Nectarie): „ΒΙΒΛΑΡΙΟΝ ΚΑΛΟΥΜΕΝΟΝ ΠΙΣΤΙΣ [...] ΝΕΑΡΙΟΥ ΤΕΡΠΟΥ [...]” (ΕΝΕΤΙΗ,ΣΙ, 732. Παρά Νικολάω τῶς Σάρω, ἀψλβ΄ [1732] Con Licenza de‘ Superiori e Privilegio.)

## **b) Literaturë e cituar**

Atasanov, Petar

- 2002 Aromunisch. Në: Wieser Enzyklopedie des europäischen Ostens, Bd. 10: Lexikon der Sprachen des europäischen Ostens (ed. M. Okuka). Klagenfurt – Wien – Ljubljana, f. 77-82

Caraciu-Marioțeanu, Matilda

- 1962 Liturghier aromînesc. București
- 1968 Dialectul Aromân. Në: “Crestomație Romanică”, vol. III Editura Academiei Române, București (internet: <www.proiectavdhela.ro>)

Courth, Franz

- 1996 Marianische Gebetsformen. Në: (Beinert, W. & Petri, H. – ed.) Handbuch der Marienkunde, Bd. 1. Regensburg

Çabej, Eqrem

- 1968 «Meshari» i Gjon Buzukut i Gjon Buzukut (1955). Botim kritik. Punuar nga Eqrem Çabej, Pjesa I: Hyrje dhe transliterim; Pjesa II: Faksimile dhe transkribim fonetik. Tiranë

Demiraj, Bardhyl

- 2017 Areali kulturor i Veriut në shek. XVI-XIX. Tiranë

Drimba, Vladimir

- 1955 Asupra unui text aromîn din anul 1731. Në: “Studii și Cercetări Linguistice” 3-4, f. 343-5

FGJSSH Fjalor i Gjuhës së sotme Shqipe (ASHRSSH) Tiranë 1981

Giakoumis, Konstantinos

- 2017 Textual Visuality & Visual Textuality in Texts Correlated with Artworks. Nektarios Terpos’ Pistis and Last Judgement Scenes from Myzeqe, central Albania. Në: “Texts, Inscriptions, Images” (Art Readings. Thematic annual peer-reviewed edition in Art Studies in two volumes 2016/ vol. I – Old Art: ed. E. Moutafov & J. Erdeljan) Sofia, f. 203-244

Hetzer, Armin

- 1981 Der sog. Kodex von Berat, Teil I. Në: „Balkan-Archiv“ N.F. (6), f. 125-197
- 1981/2 Griechisch in Südalbanien im Zeitalter der Aufklärung. Untersuchungen zu der einem Priester namens Konstandin zugeschrieben Berater Handschrift vom Ende des 18. Jahrhunderts. Në: „Münchener Zeitschrift für Balkankunde“ 4, f. 169-218
- 1982a Der sog. Kodex von Berat, Teil II – Untersuchungen zu einer anonymen griechisch-albanischen handschrift vo Ende des 18. Jahrhunderts. Në: “Südost-Forschungen” (XLI), f. 132-179
- 1982b Nachlese zu: Der sogenannte Kodex von Berat I. Në: “Balkan-Archiv“ N.F. (7), f. 59-75
- 1984 Der sog. Kodex von Berat III. Në: BA (9), f. 155-177
- Kahl, Thede
- 2006 Sprache und Intention der ersten aromunischen Textdokumente (1731-1809). Në: “Studia Philologica Slavica” (Fs. Gerhard Birkefellner: ed. B. Symanzik) I. Münster / Berlin / New York, f. 245-266
- 2016 (& Prifti, Elton) Geschichte der Kodifizierung des Aromunischen. Në: “Romanische Kleinsprachen heute” (Romanistisches Kolloquium XXVII: ed. Dahmen, W. et al.). Tübingen, f. 33-65
- Legrand, Émil
- 1918 (& Louis Petit & Hubert Pernot) Bibliographie Hellénique ou description raisonnée des ouvrages publiés par des Grecs au dix-huitième siècle, t. I. Paris
- Lloshi, Xhevat
- 2008 Rreth alfabetit të shqipes. Shkup – Prishtinë – Tiranë
- Mandalà, Matteo (ed.)
- 1995 Nicolò Figlia: Il Codice Chieutino (a cura di Matteo Mandalà). Comune di Mezzojuso. Palermo
- Nevaci, Manuela
- 2014 Sisteme de scriere în dialectul aromân (cu referire la scrierile din secolul al XVIII-lea). Në: BDD-V1131@2014 Editura Universității din București (f. 297-302): <<http://www.diacronia.ro/en/indexing/details/V1131>>
- Papahagi, Tache
- 1963 Dictionarul dialectului aromân – general si etimologic. Bucarest
- Popa, Theofan
- 1998 Mbishkrime të kishave në Shqipëri. Tiranë
- Shuteriqi, Dhimitër
- 1952 Gjashtë tekste të vjetra shqipe të shek. XVII-XIX. Në: “Buletin i

- Shkencave Shoqërore” 3 [1952] 14-15
- 1976 Shkrimet shqipe në vitet 1332 – 1850. Tiranë
- 2005 Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800. Tiranë
- Țipău, Mihai
- 2010 Autour des premiers textes écrits en aroumain. Në: “Revue des Études Sud-Est Européennes” XLVIII, 1-4 [2010] 239-253. Bucarest